FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Akte të papublikuara **Ekstra 38** **2009**

Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, datë 22.9.2009	Aplikimi nr.45265/04 "Çështja Afërdita Hamzaraj kundër Shqipërisë.....	3
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, datë 18.3.2008	Ankimi nr. 35853/04 "Çështja Bajrami kundër . Shqipërisë	5
	Ndreqje gabimi.....	8

VENDIM

(Aplikimi nr. 45265/04)
nga Afërdita HAMZARAJ
kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), më 22 shtator 2009, e përbërë nga trupi gjykues:

Nicolas Bratza Kryetar
Giovanni Bonello
David Thór Björgvinsson
Ján Šikuta
Päivi Hirvelä
LediBianku
Nebojša Vučinić gjyqtarë,
dhe Lawrence Early, regjistrues i seksionit,
duke pasur parasysh kërkesën e mësipërme të paraqitur më 27 nëntor 2004,
duke pasur parasysh vërejtjet e paraqitura nga qeveria e paditur dhe vëzhgimet në përgjigje të tyre të paraqitura nga ankuesja,
mbasi diskutimit të çështjes, vendosi si vijon:

FAKTET

Ankuesja, znj.Afrdita Hamzaraj është shtetase shqiptare e cila ka lindur në vitin 1926 dhe jeton në Vlorë. Ajo përfaqësohet para Gjykatës nga znj.M. Xibinaku. Qeveria Shqiptare ("Qeveria") është përfaqësuar nga agjenti i tyre, znj. E. Hajro.

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes, të paraqitura nga palët, mund të përmblidhen si më poshtë.

Më 16 shkurt 1995 Gjykata e Rrethit Lushnjë ka njohur ekzistencën e të drejtave të pronësisë të nënës së ankueses mbi një ngastër toke prej 13.000 m^2 (vendim për vërtetim fakti). Ankuesja pretendon se, sipas ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ("Ligji i pronës"), dikur në vitin 1995 ajo paraqiti një kërkesë pranë Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës Lushnjë (zëvendësuar nga Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave për arsye të Ligjit të Pronës të vitit 2006) duke kërkuar kthimin e pronës së hershme të nënës së saj. Nuk rezulton asnjë informacion i dokumentuar lidhur me zhvillimet nga viti 1995 deri në vitin 2007.

Më 28 shtator 2007, ankuesja paraqiti një kërkesë tjetër në Agjencinë Rajonale për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës ("Agjencia"), duke kërkuar përsëri kthimin e pronës së hershme të nënës së saj.

Me një letër të datës 24 tetor 2007, ankuesja njoftoi Gjykatën se agjencia nuk i kishte dhënë ndonjë konfirmim për marrjen e kërkesës të saj. Ata as nuk i kishin dhënë ndonjë afat kohor për shqyrtimin e kërkesës.

Deri më sot, agjencia nuk ka marrë ndonjë vendim.

B. Legjislacioni i brendshëm përkatës dhe praktika

1. Ligji i pronës

Neni 22 i ligjit të pronës i vitit 1993, është shfuqizuar nga ligji i pronës i vitit 2004, i cili parashikonte kushtin se ekzistenca e të drejtave pronësore mund të njihet me vendim gjykate në mungesë të dokumenteve zyrtare që do të paraqiten nga të interesuarit.

Neni 15 i ligjit të pronës i vitit 2006 parashikonte që "Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave nuk do të marrë asnjë vendim në lidhje me kërkesat (aplikimet), pretendimet e të cilëve janë bazuara vetëm në një vendim gjyqësor për njohjen e faktit juridik, (Vendim gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronës) mbi një pronë të paluajtshme, brenda kuptimit të nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile. Të gjitha kërkesat (aplikimet) të bazuara në vendime të tilla do t'u kthehen palëve [pa kryer ndonjë veprim të mëtejshëm] brenda tridhjetë ditëve nga dorëzimi i kërkesës". Agjencia rajonale shqyrton një kërkesë brenda tre muajve nga dita e

regjistrimit të saj. Ajo njofton kërkuesin, me anë të një vendimi të arsyetuar, për çdo zgjatje të afatit kohor, i cili nuk duhet të tejkalojë tridhjetë ditë shtesë.

Neni 16 parashikon procedurën e ankimit që duhet të ndiqet kundër një vendimi të agjencisë rajonale që i njeh të drejtat e pronës kërkuesit, kthimin apo kompensimin e saj. Ligji i pronës nuk përmban asnjë procedurë ankimi në lidhje me nenin 15 të saj, për rastet kur agjencia rajonale nuk ka marrë ndonjë vendim.

Dispozitat e tjera përkatëse të ligjit të pronës janë përshkruar në vendimet Gjonbocari kundër Shqipërisë (nr.10508/02, 23 tetor 2007); Driza kundër Shqipërisë (nr.33771/02, 13 nëntor 2007), dhe Ramadhi kundër Shqipërisë (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007).

a) Vendimi i Këshillit të Ministrave mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (Vendimi nr. 566, datë 23 gusht 2006)

Vendimi përcakton skemën organizative të Agjencisë, e cila përbëhet nga 12 zyra rajonale. Ai parashikon procedurën e emërimit të stafit të saj menaxhues dhe detyrat e përgjegjësitë e tyre përkatëse.

b) Vendimi i Këshillit të Ministrave në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e kërkesave nga partitë e shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimin dhe kompensimin e pronave (Vendimi nr. 747 të 9 dhjetorit 2006).

Vendimi parashikon listën e dokumenteve që kërkohen të jenë pjesë e kërkesës së subjektit të shpronësuar për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës. Kërkesa duhet dorëzuar në zyrën rajonale.

Në qoftë se kërkesa është e plotë, zyra rajonale i cakton një numër regjistrimi (protokolli). Në të kundërt, zyra rajonale ia kthen kërkesën personit të shpronësuar për paraqitjen e dokumenteve që mungojnë.

Vendimi nuk parashikon ndonjë afat kohor, brenda të cilit zyra rajonale duhet të shqyrtojë një kërkesë.

2. Kodi i Procedurës Civile

Neni 388 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se çdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë me anë të një vendimi gjyqësor, njohjen (vërtetimin) e një fakti , kur akti që e vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, me kusht që ky fakt është përcaktues për lindjen, ndryshimin ose shuarjen e të drejtave personale apo pasurore.

3. Praktika e brendshme

Praktika e brendshme e Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës (zëvendësuar nga Agjencia) ka qenë unike në atë që ajo duhej të vendoste njohjen e të drejtave të pronësisë së ankuesit mbi një ngastër toke, pasi kërkuesi zotëronte një vendim gjyqësor që i njihte fakti juridik të ekzistencës së të drejtave pronësore.

Gjykata e Lartë është shprehur mbi praktikën e Komisionit në disa nga vendimet e saj të fundit (për shembull, vendimin nr 746/2007 të datës 31 maj 2007, nr.15/2008 të datës 18 janar 2008, dhe vendimi nr.304/1998 i datës 29 maj 2008). Megjithatë, në vendimet e saj nr. 746/2007 të datës 31 maj 2007 dhe 98/2008 të datës 14 shkurt 2008 në lidhje me një mosmarrëveshje për pronën, Gjykata e Lartë ka shtuar se "një vendim gjyqësor i dhënë sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile nuk duhet të interpretohet si i detyrueshëm për autoritetet administrative, por si një dokument udhëzues për t'u mundësuar atyre që të marrin një vendim në përputhje me ligjin dhe dokumentet që ata zotërojnë". "Në vendimin nr. 749/2007 të datës 31 maj 2007, Gjykata e Lartë ka shtuar se "një vendim i tillë gjyqësor duhet të shqyrtohet nga agjencia në lidhje me dokumente të tjera shtesë që e mbështesin, dhe do të jetë agjencia që në fund do të vendosë të pranojë apo rrëzojë kërkesën e kërkuesit [në lidhje me njohjen e të drejtave të tij të pronësisë] .

ANKESA

Ankuesja, pa iu referuar ndonjë dispozitë të veçantë të Konventës, duket se e mbështet kërkesën e saj në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës për aq sa autoritetet nuk i kanë njohur të drejtat pronësore të nënës së saj në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Lushnjë 16 shkurt 1995.

E DREJTA

Vërejtjet e qeverisë iu dërguan përfaqësuesit të ankueses me letrën e datës 15 qershor 2009, duke i kërkuar të dorëzojnë ndonjë vërejtje, së bashku me çdo kërkesë për dëmshpërblim deri me datë 25 korrik 2009.

Më 29 korrik 2009 përfaqësuesi i ankueses njoftoi Gjykatën me letrën e datës 14 korrik 2009 se ankuesja dëshironte të tërhiqte ankimin, pasi ajo nuk ishte në gjendje të provonte pretendimin e saj në lidhje me të drejtat e pronësisë.

Gjykata gjykon se, në këto rrethana, ankuesja mund të konsiderohet se nuk dëshiron të ndjekë ankimin e saj, brenda kuptimit të nenit 37 § 1 (a) të Konventës. Për më tepër, në përputhje me nenin 37 § 1 në fund, Gjykata nuk gjen asnjë rrethanë të veçantë në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut sikurse përcaktohen në Konventë dhe Protokollet e saj, të cilat kërkojnë shqyrtimin pa ndërprerje të çështjes. Për sa më lart, është e përshtatshme nxjerrja jashtë listës së gjykimit e këtij ankimi.

Për këto arsye, Gjykata njëzëri.

Vendos për nxjerrjen jashtë listës së gjykimit të këtij ankimi.

Lawrence Early
Regjistrues

Nicolas Bratza
Kryetar

SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA BAJRAMI k. SHQIPËRISË
(Ankimi nr. 35853/04)

VENDIM
(RISHIKIMI)
STRASBURG
18 Dhjetor 2007

PËRFUNDIMTAR
18/03/2008

Ky vendim merr formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Bajrami kundër Shqipërisë (kërkesë për rishikim të vendimit të 12 dhjetorit 2006),

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), me dhomë gjykuese të përbërë nga:

Z. Nicolas Bratza, Kryetar
Z. G. Bonello
Z. M. Pellonpaa
Z. K. Traja
Z. L. Garlicki
Z. L. Mijovic
Z. J. Sikuta, gjyqtarë
dhe Z. T.L.Early, regjistrues i seksionit,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura të çështjes më 27 nëntor 2007,
shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka origjinën në ankesën (nr. 35853/04) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga një shqiptar etnik nga Kosova, z. Agim Bajrami ("ankuesi"), më 27 shtator 2004.

2. Me vendimin e dhënë më 12 dhjetor 2006, Gjykata ka vendosur se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të dështimit të autoriteteve për t'i ofruar ankuesit ndonjë kuadër mbrojtës me qëllim që të sigurohej një mbrojtje praktike dhe efektive siç kërkohet nga detyrimi pozitiv i shtetit që është i sanksionuar në nenin 8, dhe se nuk kishte nevojë për të shqyrtuar veçmas ankesën sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata vendosi gjithashtu për t'i dhënë ankuesit 15.000 € (euro) për dëmin jomaterial dhe 10.000 euro për kostot dhe shpenzimet dhe rrëzoi pjesën tjetër të pretendimeve për një shlyerje të drejtë.

3. Më 28 qershor 2007 Qeveria ka informuar Gjykatën se ata kishin marrë dijeni se ankuesi kishte vdekur më 10 nëntor 2006. Ndaj në përputhje me rrethanat, ajo ka kërkuar rishikimin e vendimit sipas kuptimit të rregullit 80 § 1 të rregullores të Gjykatës.

4. Në shtator të 2007 Gjykata ka pranuar kërkesën për rishikim (Rregulli 80 § 1 i rregullores së Gjykatës) dhe vendosi që t'i japë përfaqësuesit të ankuesit tre javë afat për të paraqitur vërejtje në lidhje me kërkesën e Qeverisë për rishikim. Këto vërejtje kanë mbërritur më 22 tetor 2007.

E DRJETA

KËRKESË PËR RISHIKIM

5. Qeveria kërkoi rishikimin e vendimit të 12 dhjetorit 2006, me arsyetimin se ajo nuk kishte qenë në gjendje për të ekzekutuar atë, sepse ankuesi kishte vdekur para se të merrej vendimi. Sipas Qeverisë, trashëgimtarët e ankuesit duhet të marrin shumat që ishin dhënë për ankuesin që ka ndërruar jetë.

6. Përfaqësuesi i ankuesit ka deklaruar se i ati i ankuesit kishte shprehur dëshirën e tij për të marrë pjesë në ekzekutimin e vendimit të Gjykatës dhe se ai nuk kishte asnjë vërejtje për të bërë mbi kërkesën për rishikim. Ai nuk iu referua vajzës së vogël të ankuesit, kujdestaria e së cilës ishte subjekt kryesor i procedurave para gjykatave vendase dhe vendimit të Gjykatës.

7. Gjykata konsideron se vendimi i 12 dhjetor 2006 duhet të rishikohet në pajtim me rregullin 80 § 1 të rregullores së Gjykatës, e cila parashikon se:

"Një palë mund, në rast se zbulon një fakt, i cili për nga natyra e tij ka një ndikim përcaktues dhe që, në momentin kur vendimi ishte dhënë, ishte i panjohur për Gjykatën dhe nuk mund të ishte logjikisht i ditur për palën, mund t'i kërkojë Gjykatës … ta rishikojë atë vendim.

…

8. Duke pasur parasysh rrethanat, Gjykata konsideron se akordimi i shpërblimit të bërë për ankuesin që ka ndërruar jetë duhet t'i paguhet trashëgimtarit ose trashëgimtarëve të tij të caktuar me vullnetin e tij ose, në qoftë se ka vdekur pa lënë testament, në përputhje me dispozitat e së drejtës së brendshme që rregullon trashëgiminë ligjore. Pika 41 e vendimit të Gjykatës të datës 12 dhjetor 2006 duhet të rishikohet në përputhje me rrethanat.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI

1. Vendos të rishikojë vendimin e saj të 12 dhjetorit 2006 në lidhje me zbatimin te nenit 41 të Konventës;

në përputhje me rrethanat,

2. Vendos

a) se shteti i paditur t'i paguajë trashëgimtarit ose trashëgimtarëve të ankuesit, të caktuar me vullnetin e tij ose, në qoftë se ka vdekur pa lënë testament, në përputhje me dispozitat e së drejtës së brendshme që rregullon trashëgiminë ligjore, brenda tre muajve nga data në të cilën vendim i rishikuar të bëhet përfundimtar në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që do të konvertohen në monedhën kombëtare të shtetit të paditur sipas kursit në fuqi në datën e shlyerjes plus çdo lloj tatimi që mund të jetë në ngarkim:

i) EUR 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë euro) në lidhje me dëmin jomaterial;

ii) EUR 10.000 (dhjetë mijë euro) në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

b) që nga data e mbarimit të afatit tre mujor të lartëpërmendur deri në shlyerjen e shumave një interes i thjeshtë do të paguhet mbi shumat e mësipërme sipas një kursi të barabartë me normën margjinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit duke i shtuar tre për qind;

3. Rrëzon pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për shlyerje të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim në 18 dhjetor 2007, në pajtim me rregullin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L. EARLY
Regjistrues

Nicolas BRATZA
Kryetar

NDREQJE GABIMI

1. Në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.35 (Akte të papublikuara) në vendimin "Xheraj kundër Shqipërisë" në faqen nr.13, në pjesën e dispozitivit, pika 2

Ishte:

"Vendos se nuk ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës"

Bëhet:

"Vendos se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës"

2. Në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.35 (Akte të papublikuara) në vendimin "Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë", pas pikës 30, shtohen pikët nga 31 deri në 40.

4.Shqyrtimi i dytë në interes të ligjit

31. Në një datë të papërcaktuar KG ka paraqitur një ankim në Gjykatën e Lartë për rishikim në interes të ligjit kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit të Tiranës të datës 7 tetor 1996 të vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës të datës 2 dhjetor 1996, dhe vendimit të Gjykatës së Lartë të 5 shkurtit 1998, pasi ishin në shkelje të ligjit material.

32. Më 12 maj 2000 Gjykata e Lartë (me Kolegje të Bashkuara) vendosi në zbatim të procedurës për rishikim në interes të ligjit të prishë vendimet e sipërpërmendura dhe, duke vendosur mbi meritat (në themel), ka deklaruar si të pavlefshëm urdhrin e datës 8 tetor 1992 që i jepte titullin e pronësisë.

33. Ankuesit kanë paraqitur një kërkesë para Gjykatës Kushtetutese në bazë të nenit 131§ f të Kushtetutës.

34. Më 3 korrik të vitit 2002 Gjykata Kushtetuese *de plano* vendosi për të deklaruar kërkesën e ankuesve si të papranueshëm pasi ishte "jashtë juridiksionit të saj".

II.LEGJISLACIONI PËRKATËS DHE PRAKTIKA VENDASE

A.Ligji relevant vendas

35.Kushtetuta e Shqipërisë parashikon:

Neni 42 § 2

"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj…

Neni 131

"Gjykata Kushtetuese vendos për:

…

(f) f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.".

36. Sipas Kodit të Procedurës Civile të vitit 1996, i cili ishte në fuqi në atë kohë, vendimet bëheshin përfundimtare në rrethanat e mëposhtme:

Neni 451

Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur nuk mund të bëhet ankim kundër tij, nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr; ankesa e paraqitur nuk është pranuar; vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë, vendimi bëhet ligjërisht detyrues kur gjykata më e lartë jep vendimin e saj…"

37. Sipas dispozitave në fuqi në atë kohë, rekursi në interes të ligjit ishte një mjet ligjor ankimimi i jashtëzakonshëm që i mundësonte gjykatat të rihapnin procedimet pas një vendimi përfundimtar (Rekurs në interes të ligjit). Midis vitit 1996 dhe shfuqizimit të tij në vitin 2001 me

ligjin nr.8812 të datës 17 maj 2001, rekursi në interes të ligjit ka qenë subjekt i disa ndryshimeve legjislative.

Neni 473-Rekursi në interes të ligjit

Kundër vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit, si dhe vendimeve të kolgjeve të Gjykatës së Lartë, palët kanë të drejtë që për shkaqet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, të bëjnë rekurs në kolegjet e bashkuara, brenda 3 viteve nga marrja formë të prerë e vendimit.

Rekursi shqyrtohet në dhomën e këshillimit nga një kolegj seleksionues i përbërë nga pesë gjyqtarë të caktuar me short. Në kolegjin seleksionues nuk mund të jenë gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen. Kolegji cakton me short nga gjiri i tij relatorin.

Vendimi për kalimin e rekursit në gjykim merret me shumicë votash. Relatori i çështjes në kolegjet e bashkuara caktohet me short nga gjyqtarët që nuk kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes, ashtu dhe në kolegjin seleksionues. Gjykimi në kolegje të bashkuara për të njëjtën çështje mund të bëhet vetëm një herë.

38. Nenet përkatës të ligjit për pronë (Kthimin dhe kompensimit) janë përshkruar në çështjet *Beshiri dhe të tjerë k.Shqipërisë* (nr.7352/03 §§ 21-29, 22 gusht 2006), *Driza kundër Shqipërisë* (nr.3377/02, §§ 36-43, ECHR 2007…(ekstrakte) dhe *Ramadhi dhe të tjerë k.Shqipërisë* (nr.38222/02, §§ 23-30, 13 nëntor 2007).

39. Neni 5(d) i ligjit "Për…rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë" (Ligji nr.7514 të datës 30 shtator 1991) u njihte të drejtën viktimave të shtypjes së diktaturës që të kërkonin kthimin e pronave të tyre që kishin qenë të konfiskuara apo të shtetëzuara.

E DREJTA

I.SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 §1 Të KONVENTËS

40. Ankuesit u ankuan sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me shkeljen e parimit të sigurisë ligjore, për aq sa vendimi përfundimtar në favor të tyre ishte prishur sipas procedurës për rekursin në interes të ligjit. Ata gjithashtu u ankuan në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës, e cila kishte zgjatur rreth tetë vjet, dhe çështja kishte qenë shqyrtuar në gjashtëmbëdhjetë instanca nga gjykatat

Pjesët përkatëse të nenit 6 § 1 të Konventës sigurojnë:

""Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile…, çdokush ka të drejtë …të një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm…nga [një]…gjykatë…

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 18.11.2009
Doli nga shtypi më 19.11.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 12 lekë